

# MARCONOL CERATO

FINITURË KUNDRA UJIT SEMILUCIDO (GJYSËM-SHKËLQIM) ANTIGËRVISHTJE PËR DRU PËR JASHTË  
seri 863

## PËRSHKRIMI

MARCONOL CERATO është produkt i përshtatshëm për mbushjen (impregnazione) dhe mbrojtjen e drurit.

Ka fuqi të lartë penetruese të nevojshme për mbrojtjen nga agjentët atmosferike dhe ndotësit edhe në ambiente me kushte të motit ekstreme, duke mbetur i paprekshëm/pacënuar nga variacionet strukturale natyrale të drurit.

Përbërja e veçantë e MARCONOL CERATO I siguron përfundimin e finiturave riemplitive dhe kundra ujit (që nuk përçojnë ujë) pasi formon një film mikroporoz shumë transpirant ndaj avujve të ujit; druri i trajtuar mban të paprekur/pacënuar ekuilibrin natyral igrometrik, duke shmangur krijimin e plasaritjeve të llaqeve tradicionale sintetike për dru, prandaj produkti mund të mirëmbahet lehtësisht.

MARCONOL CERATO përmban aditivë të veçantë, absorbues të rrezeve ultravjollcë dhe mund të pigmentohet me pigmente transparente që ngjyrosin drurin pa maskuar/fshehur damarët.

## UDHËZIME PËR PËRDORIMIN

I aplikueshëm në dru për jashtë dhe për brenda:  
Sipërfaqe në dru të ri, të vjetër dhe të lyer më parë si papafingo, korniza dritësh,, ballkone, gardhe, shkallë, objekte të ndryshme etj.  
VEMENDJE në trajtimin e drurëve të pasur me taninë (psh. gështenjë) mund të shfaqin njolla të errëta.

## KARAKTERISTIKA TEKNIKE

- Natyra e lidhësit: rezinë alkidike e modifikuar
- Pigmente: oksid hekuri transparent, rezistent ndaj rrezeve U.V.
- Solventi: përzierje e hidrokarbureve alifatike
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 0,90-0,94 kg/l (sipas ngjyrave)
- Viskoziteti i paketimit UNI 8902: 208 ± 24 cps në 25 °C (viskozimetër rrotullues Brookfield)
- Shkëlqimi UNI EN ISO 2813: 30±10 këndi i leximit 60°
- Tharja (në 25 °C dhe 65% di U.R.): larg pluhurit (fuori polvere) për 2 orë; në prekje pas 8 orësh; shtresa tjetër pas 24 orësh.

## PËRGATITJA E SIPËRFAQES

### Sipërfaqe druri të reja ose të përpunuara:

- Zmeriloni lehtë për të hequr/larguar fibrat e ngritura të drurit.
- Hiqni rezinën/llakun e pranishëm duke përdorur diluentin e përshtatshëm.
- Stukoni parregullsitë me stuko sintetike. Zmeriloni stukimet dhe eliminoni pluhurin.
- Kontrolloni që druri të mos jetë shumë i lagësht.
- Në dru të butë dhe të thatë ose shumë absorbues, aplikoni një shtresë MARCONOL IMPREGNANTE të ngjyrosur s. 843.
- Zmeriloni sipërfaqet dhe më pas vazhdoni me aplikimin e 2 shtresave MARCONOL CERATO.

### Sipërfaqe në dru të lyer:

- Zmeriloni për të hequr/larguar fibrat e ngritura të drurit.
- Eliminoni shtresat e bojës së vjetër të ciflosur dhe ashpëroni/zmeriloni të gjithë sipërfaqen e lyer.
- Hiqni rezinën/llakun e pranishëm duke përdorur diluentin e përshtatshëm.
- Stukoni parregullsitë me stuko sintetike. Zmeriloni stukimet dhe eliminoni pluhurin.
- Në zonat e degraduara ose shumë absorbuese, aplikoni një shtresë MARCONOL IMPREGNANTE të ngjyrosur s. 843.
- Zmeriloni sipërfaqet dhe më pas vazhdoni me aplikimin e 2 shtresave MARCONOL CERATO.

## UDHËZIME PËR APLIKIM

Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes  
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C

Lagështira relative e ambientit: <75%  
Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C

- Lagështira e sipërfaqes: <10%
- Shmangni aplikimet në prani të sipërfaqeve me kondensim ose nën veprimin direkt të diellit.
- Mjetet: pinel, rrul.
- Ripërzieni në mënyrën e duhur produktin para përdorimit.
- Produkti është gati për përdorim. Në momentin që sipërfaqja rezulton pak absorbuese holloni 3% me Acquaragia 5200010 ose me Dil. Sintetik 5210011 për të favorizuar penetrimin.
- Aplikimi me spruco mund të kryhet ekskluzivisht në kontekstin e aktiviteteve që janë subjekt i autorizimeve për emisionin (lëshimin) në atmosferë (art. 267 dhe ndjekur nga D.L nr. 152/2006), hollimi paraprak 10% me Acquaragia 5200010.

# MARCONOL CERATO

FINITURË KUNDRA UJIT SEMILUCIDO (GJYSËM-SHKËLQIM) ANTIGËRVISHTJE PËR DRU PËR JASHTË  
seri 863

-Nr i shtresave: produkti aplikohet në 2 shtresa. Në kushte ambienti veçanërisht të rënda ose në sipërfaqe shumë absorbuese është I këshillueshëm aplikimi në 3 shtresa.

-Për aplikimet në sipërfaqe të jashtme këshillohet të përdoret MARCONOL CERATO me ngjyrë, duke qenë se janë pigmentet (oksid hekuri) që zhvillojnë funksionin mbrojtës nga rrezet UV.

-Pastrimi I mjeteve bëhet me Acquaragia 5200010.

-Shkalla e mbulimit: 4-5 m<sup>2</sup>/l në 2 shtresa për dru mesatarisht absorbues. Është mirë që të përcaktohet rrezja efektive me një provë paraprake në sipërfaqe specifike konsumi.

## NGJYROSJA

Produkti është I disponueshëm në versionin pa ngjyrë dhe në ngjyrat e katalogut që përputhen me pastat kolorantë të sistemit tintometrik MARCROMIE (deri në 3% max).

## MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30 °C  
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 °C  
Produkti preferohet të përdoret brenda 3 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

## UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)  
Kat. A/e: llaqe dhe mbushësa (impregnanti) për dru për finitura brenda/jashtë (bazë solventi): 400 g/l (2010)  
MARCONOL CERATO Përmban max: 400 g/l VOC

I ndezshëm. / Në rast zjarri përdorni fikëse shkume, pluhuri kimik ose CO<sub>2</sub> –mos përdorni ujë / Mbajeni larg përdorimit nga fëmijët / Mos I hidhni mbetjet/ambalazhet në kanalizime, terren. / Në rast të gëlltitjes, konsultohuni menjëherë me mjekun dhe i tregoni enën ose etiketën. Produkti duhet të transportohet, përdoret dhe ruhet sipas rregullave aktuale të shëndetit dhe sigurisë; pas përdorimit mos I hidhni mbetjet në

ambient, I lini të thahen dhe I trajtoni ato si mbetje të veçanta. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

## SPECIFIKIMET

Mbushës (Impregnante) - finitura kundër ujit për dru.

Aplikimi, në sipërfaqe druri të predispozuar, për mbushës- finitura kundër ujit për dru për brenda dhe jashtë MARCONOL CERATO seri 863, me bazë rezinë alkidike të modifikuar, oksid hekuri transparent të mikronizuar dhe mbrojtës kundër rrezeve ultravjollcë, në të paktën 2 shtresa, në sasinë e caktuar nga absorbimi I sipërfaqes. Furnizimi dhe instalimi i materialit € ..... për m<sup>2</sup>.

*SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.*